VENDIM
Nr.31, datë 5.7.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i " "
Petrit Plloçi	Anëtar	i " "
Vitore Tusha	Anëtare	e " "
Sokol Sadushi	Anëtar	i " "
Sokol Berberi	Anëtar	i " "
Admir Thanza	Anëtar	i " "
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e " "
Vladimir Kristo	Anëtar	i " "

me sekretare Blerina Çinari, në datën 21.4.2011 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.9 Akti që i përket:

KËRKUES: Marketin Topallaj

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, në mungesë
2. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në mungesë
3. Kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në mungesë

OBJEKTI:

1. Pranimi i padisë dhe shpallja si e papajtueshme me Kushtetutën e moslirimit të pronës.
2. Prishja e vendimit nr.00-2008-1033, datë 16.10.2008 të Gjykatës së Lartë.
3. Prishja e vendimit nr.656, datë 6.6.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë.
4. Prishja e vendimit nr.1914, datë 6.4.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
5. Detyrimi i Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë dhe i komisariatit përkatës të Policisë Tiranë për të liruar pronën truall 2000 m^2 , të ndodhur në Mëzez (Tiranë), e cila është në pronësi të kërkuesit.
6. Detyrimi i Qeverisë Shqiptare për të dëmshpërblyer kërkuesin, për shkak të dëmit pasuror, të ardhur si pasojë e moslirimit të pronës së sipërpërmendur me vlerën prej 10.965 milionë euro.
7. Shfuqizimi i dispozitave të mëposhtme të nenit 128 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit": "Ligji nr.7498, datë 5.7.1991 "Për ruajtjen e rendit dhe qetësisë" (i ndryshuar), si dhe akte të tjera normative në fuqi, që rregullojnë veprimtarinë e Policisë, por që bien ndesh me këtë ligj, shfuqizohen".

BAZA LIGJORE: Nenet 41/1,2, 42, 43, 131/f, 134/g dhe 142/3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe neni 1 i protokollit 1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, kërkuesin, që kërkoi pranimin e kërkesës dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kërkuesi është pronar i një trualli prej 2000 m^2 të ndodhur në Mëzez (Tiranë). Në datën

24.2.1997 persona të tretë e zhveshën kërkuesin nga posedimi, duke mos e lejuar atë ta gëzonte sendin. Kërkuesi iu drejtua organeve të Policisë së Shtetit që, në përputhje me nenin 6 të ligjit nr.7948, datë 5.7.1991 "Për ruajtjen e rendit dhe qetësisë" (i ndryshuar), të ndërhynin për të mundësuar lirimin e pronës nga të tretët dhe vendosjen e saj në posedim të kërkuesit.

Duke qenë se organet e Policisë së Shtetit nuk vepruan, kërkuesi iu drejtua me kërkesë-padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke i kërkuar kësaj të fundit të detyronte organet përkatëse të Policisë së Shtetit që të vepronin në përputhje me ligjin e sipërcituar, për të mundësuar rivendosjen në posedim të kërkuesit.

Me vendimin nr.1914, datë 6.4.2005, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë rrëzoi padinë si të pabazuar në prova dhe në ligj.

Pas ankimit të kërkuesit, Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.656, datë 6.6.2006, vendosi lënien në fuqi të vendimit të sipërcituar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Pas rekursit të bërë nga kërkuesi në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit me vendimin nr.00-2008-1033, datë 16.10.2008 vendosi lënien në fuqi të vendimit të sipërpërmendur të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Në datën 16.9.2010 kërkuesi i ka drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) kërkesën me objektin e mësipërm.

Kërkuesi pretendon se gjatë gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë janë shkelur parimet e mëposhtme kushtetuese:

i) Parimi i gjykimit nga një gjykatë e pavarur, për shkak se të dy gjyqtarët e caktuar për të gjykuar çështjen e kërkuesit ishin caktuar pa short.

ii) Parimi i pjesëmarrjes së palës në gjykim, pasi pala e paditur nuk ka qenë e pranishme gjatë gjykimit dhe se gjyqtarja M.Xh ka bërë bashkimin në një seancë të vetme prej 30 minutash të tri fazave të veçanta gjyqësore.

iii) Parimi i gjykimit nga një gjykatë e paanshme, për shkak se gjykata e shkallës së parë nuk ka kryer asnjë lloj hetimi gjyqësor, por ka pranuar si të mirëqenë variantin e palës së paditur, të cilin e ka përfituar në rrugë jashtëgjyqësore dhe, se si u tha më sipër, ka kryer vetëm një seancë prej 30 minutash, në të cilën ka përmbledhur tri faza gjyqësore.

iv) Parimi i një gjykimi të drejtë për shkak se gjykata ka keqinterpretuar dispozitat e ligjit nr.7948, datë 5.7.1991 "Për ruajtjen e rendit dhe qetësisë" (i ndryshuar). Ka keqinterpretuar faktin nëse ky ligj është në fuqi apo jo, kur ka argumentuar se ligjit nr.7948, datë 5.7.1991 "Për ruajtjen e rendit dhe qetësisë" (i ndryshuar), është shfuqizuar nga ligji nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit". Gjithashtu, gjykata ka keqinterpretuar natyrën e kërkesë-padisë, duke argumentuar se kërkuesi nuk mund të pretendonte ndërhyrje nga organet e Policisë së Shtetit, për arsye se, duke qenë se kishte një mosmarrëveshje civile me të tretë, duhet të ndiqte rrugën gjyqësore të parashikuar në Kodin e Procedurës Civile.

II

1. Për pretendimin se është cenuar neni 42/2 i Kushtetutës, pasi gjyqtarët në të dyja nivelet e juridiksionit të zakonshëm janë caktuar pa short

Gjykata e shqyrton caktimin e gjyqtarit nëpërmjet shortit, në funksion të parimit të një gjykate të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, si një element thelbësor për një proces të drejtë dhe të rregullt ligjor, i cili mënjanon paragjykimin e çështjes, rrit besimin e shtetasve te sistemi i drejtësisë dhe transparencën e këtij të fundit.

Në traditën e së drejtës kushtetuese europiane caktimi i gjyqtarit me short në kuadrin e të ashtuquajturit "gjyqtari natyral", është zhvilluar si standard në lidhje të ngushtë dhe në respekt të parimeve që janë të shprehura në mënyrë eksplicite edhe në nenin 42/2 të Kushtetutës.

Në Republikën e Shqipërisë caktimi i gjyqtarëve me short bëhet nga kancelari i gjykatës, në përputhje me nenin 154/a të Kodit të Procedurës Civile dhe rregullat e vendosura nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Caktimi i gjyqtarit pa short, jashtë kritereve të përcaktuara rigorozisht në ligj, në kuptim

të respektimit të parimit kushtetues të një gjykate të caktuar me ligj, ngre probleme serioze kushtetutshmërie.

Duke pasur parasysh se besimi i qytetarëve te sistemi i drejtësisë është një nga elementet thelbësore të mirëfunksionimit të shtetit të së drejtës, është e domosdoshme që gjykata të jetë dhe të shfaqet e paanshme në sytë e publikut të gjerë.

Debati në jurisprudencën dhe doktrinën europiane, nëse termi "gjykatë" kur flitet për gjykatë të caktuar me ligj, i takon vetëm gjykatës të identifikuar si organi kompetent për lëndë dhe territor për të zgjidhur çështjen konkrete dhe jo gjyqtarëve si persona fizikë është një problem, i cili është zgjidhur pikërisht nga neni 154/a i Kodit të Procedurës Civile. Ky nen ka parashikuar se gjyqtari "natyral" për të zgjidhur çështjen konkrete, është ai që identifikohet, pasi është hedhur shorti dhe çdo procedurë e ndryshme ligjore jo vetëm do t'i binte ndesh ligjit, por do të ishte njëkohësisht në kundërshtim me standardin e sanksionuar në nenin 42/2 të Kushtetutës.

Standardi i gjykimit të shtetasve nga një gjykatë e caktuar me ligj është tashmë një standard i konsoliduar, si nga vendimet e kësaj Gjykate, ashtu edhe nga ato të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ).

Gjykata është shprehur se gjykimi i çështjes nga një gjykatë "e caktuar me ligj" është një element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-së) (*shih vendimin nr.31, datë 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese)*.

Gjykata ka theksuar, gjithashtu, në jurisprudencën e saj se e drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur, e të caktuar me ligj, kërkon, gjithashtu, që drejtësia jo vetëm të bëhet, por ajo duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimin nr.31, datë 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, lipset që organet e administrimit të drejtësisë duhet të garantojnë transparencën dhe dokumentimin e të gjitha veprimeve të kryera.

Doktrina dhe jurisprudenca kushtetuese europiane, ndër vite, adoptuan disa kritere themelore, për të garantuar që shtetasi do të gjykohej nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Para së gjithash gjykata duhet të jetë e krijuar me ligj, ku të jetë përcaktuar qartë kompetenca lëndore dhe tokësore e saj në shqyrtimin e çështjeve. Me fjalë të tjera, ligji për krijimin e gjykatës duhet t'i paraprijë shqyrtimit të çështjeve konkrete. Në këtë linjë është vlerësuar edhe nevoja e domosdoshme për caktimin e gjyqtarit me short për shqyrtimin e një çështjeje para se të bëhen publike rrethanat e çështjes dhe palët në gjykim. Vende të ndryshme përdorin metoda të ndryshme të hedhjes së shortit.

Në po të njëjtën linjë qëndron edhe jurisprudenca e GJEDNJ-së, sipas së cilës: "Një tribunal karakterizohet në kuptimin thelbësor të shprehjes nga funksioni i tij gjyqësor, me të cilin duhet kuptuar të vendosurit mbi çështjet brenda kompetencave të tij, bazuar në rregullimet ligjore dhe sipas procedurave të zhvilluara në mënyrë të përcaktuar. Ai duhet, gjithashtu, të kënaqë një numër kërkesash të mëtejshme, si: pavarësia, veçanërisht prej ekzekutivit; paanshmëria; qëndrueshmëria në detyrë e anëtarëve të tij; garancitë e ofruara nga procedura e tij, disa prej të cilave shfaqen edhe në vetë tekstin e nenit 6/1 të KEDNJ-së." (*shih vendimin Belilos v. Zvicrës, datë 29.4.1988*). Për sa më sipër, procedurat, të cilave u referohet GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj, përfshijnë edhe procedurën e hedhjes së shortit.

Gjykata vëren se parimet e përcaktuara në nenin 42 të Kushtetutës nuk mund t'i referohen vetëm organit gjyqësor kompetent, në lëndë dhe territor, për të gjykuar një çështje të caktuar, por i referohen edhe gjyqtarit ose trupës gjykuese, e cila investohet me zgjidhjen e çështjes konkrete. Në këtë kuptim, një procedurë jokorrekte në përcaktimin e gjyqtarit ose trupës gjyqësore nuk është në përputhje me Kushtetutën.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe GJEDNJ-ja, e cila në një rast analog, ku kërkuesi pretendonte se i ishte cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar nga neni 6 i KEDNJ-së, për arsye se gjyqtarët ishin caktuar pa short.

GJEDNJ-ja konstatonte në rastin e sipërpërmendur: "Gjithsesi, veçmas dështimit të

dukshëm për të respektuar detyrimet që burojnë nga ligji për gjyqtarët popullorë (Lay Judges), Gjykata është veçanërisht e shtangur (struck) nga fakti se autoriteti i distriktit të Neklinovskiy-it (organi përgjegjës për caktimin e gjyqtarëve popullorë) ka konfirmuar se nuk kishte lista të gjyqtarëve popullorë, të caktuar para datës 4 shkurt të vitit 2000. Në këtë mënyrë autoritetet dështuan të paraqesin ndonjë bazë ligjore për pjesëmarrjen e znj. Streblyanskaya dhe znj. Khovyakova në administrimin e drejtësisë në ditën e gjykimit të kërkuesit ..." *(shih vendimin Posokhov v. Rusisë e vitit 2003*).

Për sa më sipër, përfundimi që nxirret është se autoritetet shtetërore duhet jo vetëm të respektojnë kërkesat ligjore për hedhjen e shortit, por njëkohësisht duhet të dokumentojnë kryerjen e një procedure të tillë nga personat përgjegjës.

Gjykata i vlerëson pretendimet e kërkuesit në kuptim të përmbushjes të standardeve të mësipërme. Në kohën e shqyrtimit të çështjes gjyqësore procedura e hedhjes së shortit rregullohej me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.1830, datë 3.4.2001. Pika 4 e nenit 8 të tij detyronte kryetarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit që të mbikëqyrnin procesin e organizimit dhe të dokumentimit të ndarjes së çështjeve gjyqësore nëpërmjet shortit, si dhe të nënshkruanin përcjelljen e çështjes gjyqësore te gjyqtari i caktuar.

Nga shqyrtimi i materialeve të çështjes gjyqësore në ngarkim të kërkuesit, Gjykata konstaton se në vendimin e datës 8.12.2004 të Kryetarit të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi pranohej kërkesa për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes, në ngarkim të kërkuesit të gjyqtares F.B., urdhërohej hedhja e shortit për caktimin e një gjyqtari tjetër. Gjykata vëren, gjithashtu, se në dosjen gjyqësore (kopertinë) gjendet nënshkrimi i nënkryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, krahas emrit të gjyqtarit që ngarkohej me shqyrtimin e çështjes. Gjykata konstaton se në vendimin e seancës përgatitore, gjyqtarja, që ka shqyrtuar çështjen, është shprehur se asaj i është ngarkuar çështja me short. Gjithashtu, Gjykata vëren se, pasi pala kërkuese ka marrë dijeni për caktimin me short të gjyqtares, nuk ka ngritur asnjë pretendim në lidhje me shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes nga i njëjti gjyqtar.

Në seancën plenare të zhvilluar për këtë qëllim, kërkuesi nuk arriti të paraqesë prova në mbështetje të pretendimeve të ngritura, se për shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë nuk është hedhur shorti për caktimin e gjyqtarëve.

Për sa më sipër, Gjykata krijon bindjen se në caktimin e gjyqtarëve, për të shqyrtuar çështjen e kërkuesit, është respektuar procedura e hedhjes së shortit. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenim të parimit të gjykatës të caktuar me ligj, të parashikuar nga neni 42/2 i Kushtetutës, duhet rrëzuar si i pambështetur në dokumentet e administruara në dosjen gjyqësore.

2. Për pretendimin se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë keqinterpretuar ligjin material dhe argumentet e paraqitura nga kërkuesi

Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesit për interpretim të gabuar të ligjit nr.7948, datë 5.7.1991 "Për ruajtjen e rendit dhe qetësisë" (të ndryshuar) nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk mund të merren në shqyrtim nga kjo Gjykatë.

Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur në mënyrë të vazhdueshme, se interpretimi i ligjit material e procedural, si dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues (*shih vendimin nr.14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr.31, datë 1.12.2005 dhe nr.22, datë 22.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

Për sa më sipër, Gjykata nuk është kompetente të shqyrtojë pretendime në lidhje me interpretimin e ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe, për rrjedhojë, pretendimet e

ngritura nga kërkuesi dalin jashtë juridiksionit të saj.

3. Për pretendimin për dëmshpërblimin e dëmit jashtëkontraktor si pasojë e moslirimit të pronës nga ana e Policisë së Shtetit

Për sa i përket kërkesës për dëmshpërblimin e dëmit, Gjykata çmon se kjo kërkesë nuk është në kompetencë të saj, por të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se kërkime të kësaj natyre mund të paraqiten në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në bazë të dispozitave të Kodit Civil që kanë të bëjnë me kompensimin e dëmit të shkaktuar, si rrjedhim i vonesës në pagimin e një shume parash (neni 450 i Kodit Civil). Vetëm pas ezaurimit të mbrojtjes juridiksionale, kërkuesi mund të vërë në lëvizje procedurat kushtetuese, në bazë të nenit 131/f, të Kushtetutës." (*shih vendimin nr.8, datë 23.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkesa për dëmshpërblim nuk mund të merret në shqyrtim prej saj.

4. Për pretendimin e cenimit të parimit të pjesëmarrjes në gjykim

Për sa i përket pretendimit të kërkuesit se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, pasi pala kundërshtare nuk ka marrë pjesë në gjykim, Gjykata çmon se ky pretendim është haptazi i pabazuar.

Në përputhje me nenet 42/2, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës individët vënë në lëvizje Gjykatën për mbrojtjen e interesave të veta. Në rastin konkret kërkuesi pretendon se e drejta për të marrë pjesë në gjykim i është cenuar palës kundërshtare.

Duke qenë se kërkuesi nuk ka pretenduar një cenim të të drejtave të veta kushtetuese, por të të drejtave të të tretëve, ai nuk legjitimohet që të ngrejë këtë pretendim para Gjykatës.

Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kjo kërkesë nuk mund të merret në shqyrtim prej saj.

5. Për pretendimin për cenim të parimit të paanshmërisë në gjykim

Kërkuesi ka pretenduar se gjyqtarja e vetme, gjatë gjykimit në shkallën e parë, nuk ka qenë e paanshme, pasi ka marrë të mirëqena provat e paraqitura nga pala tjetër dhe nuk ka kryer një hetim të plotë gjyqësor.

Gjykata në jurisprudencën e saj të konsoliduar është shprehur se vlerësimi i provave mbetet një çështje për t'u trajtuar nga vetë gjykatat e zakonshme dhe nuk përbën objekt kontrolli për Gjykatën Kushtetuese. Kjo e fundit mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugët dhe mënyrën e marrjes së provave, e fiksimit të tyre, por jo për mënyrën e vlerësimit (*shih vendimin nr.7, datë 27.4.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

Për sa më sipër, kërkesa, përderisa nuk ngre probleme lidhur me ligjshmërinë e marrjes së provave, por vetëm me pamjaftueshmërinë, si dhe me mënyrën e vlerësimin të tyre nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, është haptazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja "f" dhe nenit 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës; të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Sokol Sadushi, Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Admir Thanza, Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj